

DOKUMENTI KONSULTATIV

Për draftin e ligjit për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë:

- *Komente (të përgjithshme) publike;*
- *Komente nga organizatat joqeveritare (me fokus biznesin);*
- *Komente nga dhomat e biznesit;*
- *Komente nga korporatat dhe bizneset e mëdha të cilat operojnë në Shqipëri;*
- *Komente nga akademia (pedagogë, studentë, etj.).*

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik nëpërmjet publikimit në RENJK do të zgjasë 20 (njëzet) dite pune nga data e njoftimit për procesin e konsultimit publik dhe përkatësisht, nga data 31 maj 2024 deri në datë 28 qershor 2024.

Si të përgjigjeni:

Përgjigjet mblidhen përmes këtyre mënyrave:

Duke plotësuar formularin online në RENJKP.

Mbledhja e komenteve të dhëna në postën elektronike/e-mail në: info@sipermarrja.gov.al

Me postë në: Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, Tiranë 1001, Shqipëri.

Kontakti:

Martin Kajo

Martin.Kajo@sipermarrja.gov.al

Silvana Sage

Silvana.Sage@insq.gov.al

Fjorind Lika

Fjorind.Lika@sipermarrja.gov.al (koordinator)

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Takimet dhe tryezat publike do të organizohen tek Shtëpia e Biznesit, pranë Piramidës.

Sfondi i propozimit legjislativ:

Qëllimi i këtij projektligji është konsolidimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i veprimtarisë dhe sistemit të inspektimeve, për të siguruar mbrojtjen e interesit publik, forcimin e transparencës dhe llogaridhënies në veprimtaritë e inspektimit, duke pasur parasysh të drejtat e subjektit të inspektimit. Projektligji synon të garantojë pavarësinë funksionale të inspektorateve, rritjen e profesionalizmit, efektivitetit dhe performancës së trupave inspektuese nëpërmjet përdorimit të teknologjisë, si edhe duke vendosur parimet bazë të inspektimit me fokus programimin e inspektimeve dhe këshillimin dhe informimin e subjekteve të inspektimit lidhur me veprimtarinë inspektuese, në nivel qendror dhe vendor.

Propozimet:

Ky projektligj përmirëson në tërësi rregullimin e veprimtarisë së inspektimit duke përcaktuar e rregulluar:

- Parimet bazë të inspektimit;
- Riorganizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Përgjithshëm, inspektorateve qendrore dhe vendore;
- Ngritjen dhe funksionimin e Bordit të Inspektimit, si organ këshillues, bashkërendues dhe përcaktues i politikave dhe standardeve të përgjithshme të inspektimit, me përfaqësues nga ministrinë përgjegjëse në fushën e inspektimit;
- Marrëdhëniet e punësimit të inspektorit, ngritjen e sistemit të rekrutimit, karrierës dhe profesionalizmit nëpërmjet testimit, certifikimit dhe rritjes së nivelit të performancës së inspektorëve;
- Bashkërendimin dhe konsolidimin e proceseve të inspektimit, pa mbivendosje kompetencash ndërmjet organeve të ndryshme, si edhe përdorim më të mirë të burimeve njerëzore dhe publike në fushën e inspektimit;
- Dokumentet dhe procedurën e inspektimit;
- Përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit nga një burim qendror, i cili maksimizon dhe përshpejton fokusin në risqe, nxit bashkërendimin dhe ndarjen e informacionit në kohë reale, duke garantuar reagim të shpejtë dhe efektiv;
- Krijimin e një procesi transparent dhe të besueshëm për shqyrtimin e ankimit administrativ ndaj masave administrative të marra nga trupat inspektuese, duke e bërë pjesë të Inspektoratit të Përgjithshëm, duke shmangur konfliktin e interesit.

Pyetjet:

Cili do të ishte ndikimi i propozimeve të këtij ligji në veprimtarinë tuaj të biznesit?